



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ - DEGA E GJYKATËS KAÇANIK

---

Numri i lëndës: 2022:033717

Datë: 04.04.2024

Numri i dokumentit: 05545742

P.2022:055399

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ - DEGA KAÇANIK, Gjyqtari Burim Çaka me procesmbajtësin Ismail Kuqi, në çështjen penale kundër të pandehurit Y.M, i shpallur fajtor për veprën penale Rrezikim i trafikut publik nga neni 370 paragrafi 8 lidhur me paragrafin 6 dhe 1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj me numër PP/II.nr.225/22 të datës 16.03.2023, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor më datë 04.03.2024, publik, në praninë e Prokurorit të Shtetit Avdullah Abedini, të pandehurit, mbrojtësit të tij të caktuar sipas detyrës zyrtare Avokat D. R. palës së dëmtuar A.M, A. R. dhe përfaqësuesit të sajë – Avokat R. K., më datë 06.03.2024 mori dhe publikisht shpalli, ndërsa më datë 04.04.2024 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri Y.M me vendbanim në fshatin .... Komuna e Prishtinës, i lindur më datë ..., nga i ati N... dhe e ëma S... e gjinisë U..., me numër personal .., i martuar, prind i dy fëmijëve, ka të kryer shkollën e mesme, i pa punë, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës e Kosovës.

## ËSHTË FAJTOR

Sepse më datë 30.01.2022, rreth orës 16:20, në rrugën rajonale Shtërpçë-Kaçanik i Vjetër, Komuna e Kaçanikut, i pandehuri derisa ishte duke drejtuar automjetin e markës "...", ngjyrë krem, me targa të regjistrimit ..., nga pakujdesia ka shkelur ligjin mbi trafikun publik, ka rrezikuar jetën e njerëzve, duke veprua në kundërshtim me dispozitën e nenit 53.1 dhe 61.2 të Ligjit për Rregullat e Trafikut Rrugor Nr.05/L-088, më të arritur të Ura e "Fushës së Pajtimit", në dalje të nënkalimit të auto-udhës Ferizja-Hani Elezit, në atë mënyrë që i pandehuri duke mos respektuar sinjalizimin vertikal-shenjën e rrezikut, tabelën plotësuese që tregon pozitën e rrugës me përparësi kalimi dhe shenjën e urdhrit të prerë Stop, kalon në rrugën me përparësi kalimit të kahjes së kundërt dhe me pjesën e përparme të pjesës së djathtë ndeshet në anën e përparme të pjesës së djathtë me automjetin e markës "...", ngjyrë e bardhë, me targa të regjistrimit 01-780-PP, të cilën e drejtonte dëmtuara D. D., në rrugën me përparësi kalimi, si pasojë e aksidentit, **lëndim të rëndë trupor** ka pësuar A.M, ndërsa lëndime të lehta trupore kanë pësuar A. M., A. M., D. D., A. R. dhe L. M., të konstatuara në Akt Ekspertimin Mjeko Ligjor me numër Referencës : Fe-09 i datës 27.02.2022.

- Me këtë veprim ka kryer veprën penale Rrezikim i trafikut publik nga neni 370 paragrafi 8 lidhur me paragrafin 6 dhe 1 të KPRK-së.

Andaj duke u bazuar në dispozitën e lartcekur dhe nenin 2, 17, 38, 39, 43, 69, 70, 71 dhe 72 të KPRK-së dhe nenit 359, 360, 361, 365 dhe 453 të KPPK-së e gjykon me:

## DËNIM ME GJOBË

I. Dënim me burgim në kohëzgjatje prej 120 ditëve, i cili dënim me pëlqimin e të pandehurit i zëvendësohet me dënim me gjobë në shumë 1000€ (Një mijë euro), të cilin dënim i pandehuri është i obliguar ta paguaj në 4 këste të barabarta në afat prej 4 muajve pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, në të kundërtën dënimi me gjobë do t'i zëvendësohet, me dënim me burgim duke llogaritur nga 1 ditë burgim për çdo 20 € (njëzet euro) të pa paguara, nëse kësti nuk paguhet me kohë, mundësia e pagesës me këste revokohet.

II. Palët e dëmtuar kanë A. R. dhe A.M kan hequr dorë nga kërkesa pasurore juridike ndaj të pandehurit, ndërsa palët e tjera të dëmtuara udhëzohen në kontest civil.

III. Të pandehurit i ndalohet drejtimi i automjeteve i të gjitha kategorive në kohëzgjatje prej 2 (dy) viteve, i cili do të filloj të zbatohet në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

IV. Detyrohet i pandehuri që në emër të shpenzimeve të procedurës të paguaj shumën prej 170€ (110€ ekspertiza e komunikacionit dhe 20€ ekspertiza mjekoligjore), në emër të paushallit gjyqësor të paguaj në këtë gjykate shumën 50.00€ dhe në emër të Fondit për Kompensimin e Viktimave të Krimit të paguaj shumën 20 €, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi

### A r s y e t i m

Prokuroria Themelore Ferizaj ka ngritur aktakuzën PP/II.nr.225/22 të datës 16.03.2023, kundër të pandehurit të lartë shënuar për shkak të veprës penale Rrezikim i trafikut publik nga neni 370 paragrafi 8 lidhur me paragrafin 6 dhe 1 të KPRK-së dhe i ka propozuar Gjykatës që të pandehurin ta shpallë fajtor dhe t'i shqiptohet sanksioni penal konform ligjit në fuqi.

Gjykata duke vepruar sipas kësaj akuze caktoi dhe mbajti seancën e shqyrtimit gjyqësor më datë 04.03.2024.

Në këtë seancë pas dëgjimit të ekspertit të komunikacionit G. U., i pandehuri e ka pranuar fajësinë për të gjitha pikat e aktakuzës për veprën penale për të cilën është akuzuar.

Mbrojtësi i të pandehurit lidhur me pranimin e fajësisë dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar e mbështes pranimin e fajësisë nga ana e të mbrojturit tim pasi që ky pranim është bërë pas konsultimeve të mjaftueshme me mua si mbrojtës, pa presion, kërcënim apo premtim si dhe pasi që janë plotësuar kushtet ligjore për pranimin e fajësisë i propozoj gjykatës që të merr aktvendim procedural me të cilin e miraton pranimin e fajësisë, atëherë i propozojmë

gjykatës që me rastin e caktimit të llojeve të lartesisë së dënimit të kete parasysh këto rrethana lehtësuese: pranimin e fajesisë në shqyrtim gjyqësor, kërkimin për faljen e të mbrojturit tim ndaj të dëmtuarës, faktin se i mbrojturi im jeton në kushte të vështira financiare, përkatësisht është prind i 3 fëmijëve si dhe faktin se as i mbrojturi im e as bashkëshortja e tij nuk janë në një marrëdhënie të rregullt pune, që don të thotë se e kanë një jetë të vështirë financiare. Po ashtu i propozojmë gjykatës që të mos kufizohet në nenin 71 të KPRK-së, përkatësisht në zbutjen e dënimit pasi që ekzistojnë rrethana lehtësuese të cilat tregojnë se qëllimi i dënimit mund të arrihet edhe me shqiptimin e një dënimi të bute, po ashtu e bëjmë të ditur faktin se i mbrojturi im në të ardhmen e afërt do të udhëtoj jashtë vendit me qëllim të përmirësimit të kushteve të tij financiare, në atë mënyrë që fëmijëve të tij të ja mundësoj një jetë normale, prandaj edhe theksojmë faktin se shqiptimi i dënimit me kusht do të ja vështironte këtë qëllim të mbrojturit tim. Prandaj edhe e japim pëlqimin e zëvendësimit të dënimit me burgim me gjobë, në rast se gjykata e shihet arsyeshme që të mbrojturit tim të shqiptoj një dënim me gjobë atëherë me rastin e caktimit të lartesisë së gjobës i propozojmë që të kete parasysh rrethanat lehtësuese të lartecekura.

Prokurori i Shtetit ka shprehur mendimin e tij lidhur me pranimin e fajësisë, ka theksuar se nuk e kundërshton pranimin e fajësisë kundër të akuzuarit, pasi që i njëjti pas ndëgjimit dhe parashtrimet të pyetjeve të ekspertit të komunikacionit G. U. dhe konsultimeve të mjaftueshme me mbrojtësin e tij, pasi që ka kuptuar pasojat dhe benefitet e pranimit të fajësisë dhe një pranimi i tillë ka mbështetje në provat dhe faktet që gjenden në shkresat e kësaj lende, andaj i propozoj gjykatës që të aprovoj pranimin e fajësisë për të pandehurin. Gjatë fjalës përfundimtare ka deklaruar se mbetem në tërësi pranë aktakuzës dhe i ka propozuar gjykatës që të pandehurin të shpall fajtor dhe të shqiptoj një dënim me të cilin do të arrihej qëllimi i dënimit në kuptim të nenit 38 të KPP-së, ku si rrethana renduese gjykata të merr shkallën e përgjegjësisë penale, intensitetin e rrezikimit apo dëmtimit të vlerës së mbrojtjes me rastin konkret dëmtimit të shëndetit të dëmtuarve, rrethanat në të cilat është kryer vepra penale, ndërsa si rrethana lehtësuese të merr pranimin e fajit në kuptim të nenit 69 të KPRK-së.

Përfaqësuesi i palës së dëmtuar A. R. ka deklaruar mbështetjen e fjalës përfundimtare të Prokurorit të shtetit sa i përket kësaj qeshtjeje penale, duke i propozuar gjykatës që të pandehurit në përputhje me rrethanat renduese dhe lehtësuese të shqiptoj një sanksion penal për veprën

penale e cila i vihet ne barre, duke marre parasysh te gjitha rrethanat e tjera se si ka ndodhur ky rast e po ashtu numri i personave te lënduar ne kete qeshtje penale.

Pala e dëmtuar A. R. ka deklaruar se nuk i bashkangjitet ndjekjes penale dhe nuk parashton kërkesë pasuroro juridike.

Pala e dëmtuar A.M ka deklaruar se nuk i bashkangjitet ndjekjes penale dhe nuk parashton kërkesë pasuroro juridike ndaj te pandehurit.

#### *Vlerësimi i pranimet të fajësisë*

Pasi që i pandehuri e ka pranuar fajësinë gjatë shqyrtimit gjyqësor në fazën e administrimit të provave, gjykata për të vlerësuar pranimin e fajësisë e duke pasur parasysh edhe mendimin e Prokurorit të Shtetit, shqyrtoi me kujdes faktet e parapara nga neni 242 par 1 të KPPK-së dhe me këtë rast vlerësoi se: i pandehuri e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimet të fajit; Pranimi është bërë vullnetarisht, pranimi i fajit mbështet në faktet dhe prova materiale të rastit konkret dhe atë me provat e paraqitura nga Prokuroria e Shtetit të cilat gjenden në shkresat e lëndës, të gjitha këto prova të mbledhura gjatë procedurës hetimore; Akuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

Duke vlerësuar në aspektin e figurës së veprës penale gjykata gjeti se në veprimet e të pandehurit plotësohen të gjitha tiparet objektive dhe subjektive të veprës penale Rrezikim i trafikut publik nga neni 370 paragrafi 8 lidhur me paragrafin 6 dhe 1 të KPRK-së, si në mënyrë kohë dhe vend si në dispozitivin e këtij aktgjykimi

#### *Rrethanat lehtësuese dhe rënduese – matja e dënimit*

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit për të pandehurin, gjykata vlerësoj rrethanat në kuptim të nenit 69, 70 të KPRK-së, si rrethanë lehtësuese gjeti se i njëjti e ka pranuar fajësinë, është penduar për veprimin e tij dhe se i ka premtuar Gjykatës se në të ardhmen nuk do të përsërisë më veprime të tilla, nga ky askident më së shumti kanë pësuar familjarët e tij si bashkëshortja A...e cila ka pësuar lëndim të rëndë trupor dhe fëmijët, faktin se i njëjti është i gjendjes së varfër ekonomike dhe mbajtës i familjes. Ndërsa si rrethana rënduese përpos atyre kualifikuese gjykata nuk gjeti.

Gjykata, të pandehurit dënimin me burgim me pëlqimin e të pandehurit ia zëvendësoi me gjobë duke i marrë për bazë minimumin dhe maksimumin dhe qëllimin e dënimit dhe duke u bazuar në rrethanat lehtësuese dhe është i bindur se edhe me një dënim të tillë, do të arrihet qëllimi i përgjithshëm i dënimeve i paraparë në nenin 38 të KPRK-së, përkatësisht dënimi i shqiptuar është plotësisht i justifikueshëm, në përshtatje me rrethanat e kryerjes, rrezikshmërinë e saj dhe të autorit të saj, që do të shërbej në parandalimin e kryesve nga kryerja e veprave penale në të ardhmen (preventiva speciale) si dhe do të arrihet qëllimi i përgjithshëm i dënimit.

### *Kërkesat pasurore juridike*

Palët e dëmtuar kanë Ardiana Rexhepi dhe A.M kan hequr dorë nga kërkesa pasurore juridike ndaj të pandehurit, ndërsa palët e tjera të dëmtuara janë udhëzuar në kontest civil.

### *Dënimi plotësues*

Konform nenit 64 të KPRK-së të pandehurit i është ndaluar drejtimi i automjetit në kohëzgjatje prej 1 (një) viti, pasi që si pasojë e pakujdesisë së tij kanë pësuar lëndime të randa dhe të lehta palët e dëmtuara, i cili dënim do t'i shërbej të pandehurit që të rehabilitohet dhe në të ardhmën të jetë më i kujdesëshëm në komunikacion.

### *Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale*

Gjykata vendimin mbi shpenzime e procedurës dhe paushallit gjyqësor e mori konform neneve 450 dhe 452 të KPPK-ës.

Gjykata vendimin mbi Kompensimin e Viktimave të Krimit e mori konform nenit 36 paragrafi 3 pika 3.1 të ligjit Nr. 08/L-109 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Mbi bazën e të dhënave si më lartë, në bazë të neneve 242 dhe 364 të KPPK-së, u vendos si n dispozitivin e këtij aktgjykimi

**GJYKATA THEMELORE FERIZAJ**

Dega në Kaçanik

P.2022:055399 datë 04.04.2024

Gjyqtari

Burim Çaka

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi mundet të ushtrohet ankesë në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.